



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:130049

Datë: 29.09.2023

Numri i dokumentit: 04732844

**P.nr.1707/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në lëndën penale të akuzuarit K. K. nga F. K., i akuzuar për veprën penale Vjedhje nga neni 313 par.2 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2619/2021 të datë 23.06.2021, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 22.09.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Nazmi Krasniqi, i akuzuari K. K., me datë 22.09.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 29.09.2023 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

K. K.i, i biri i K dhe nëna B e gjinisë J, i lindur me ..., në F. K. , me vendbanim në F. K., në L. ... në F. K., me numër personal ..., të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Rom, Shtetase i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse:**

Me datë 24.05.2021, rreth orës 17:14, në rrugën magjistrale P.-P., saktësisht në fshatin V. K. e F. K., në marketin ‘e pikës së derivateve I. P.’ i pandehuri me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshëm vetes apo personit tjetër ti sjell dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme, në ditën kritike kishte shkuar në vendin e ngjarjes ka hyrë brenda në objekt dhe nga aty kishte vjedhur gjashtë çokollata të firmës ‘Merci’, në vlerë prej 33 Euro, me pas i njëjti është vërejtur duke kryer veprimin përmes kamerave të këtij marketi nga pronari-i dëmtuari Sh. G., duke i shkaktuar dëme materiale në vlerë prej 33 euro.

- *Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 313 par.2 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 69, 70, 71, 81, 82 dhe nenit 313 par 2 të KPRK-së si dhe neneve 240, 241, 242 par. 1 dhe 6, 358, 359, 360, 361 dhe 364, 498, 499 të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

## VËREJTJE GJYQËSORE

- I. Për veprën penale Vjedhje nga neni 313 par.2 të KPRK-së, të akuzuarit K. K., Gjykata i shqipton sanksionin penal vërejtje gjyqësore.
- II. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.
- III. Pala e dëmtuar udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest të rregullt civilo-juridik.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr.2619/2021 të datë 23.06.2021, ndaj të akuzuarit K. K. për shkak të dyshimit të bazuar mire se ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 313 par 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 22.09.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit, Nazmi Krasniqi, të akuzuarit K. K., ku i akuzuari pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, e ka pranuar fajësinë për veprën penale Vjedhje nga neni 313 par.2 të KPRK-së, i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsërisë në të ardhmen veprën penale, ka kërkuar falje Gjykatës, është penduar për këtë veprim dhe i kërkon Gjykatës që të shqiptojë një dënim sa më të butë sepse ka gjendjen e dobët ekonomike.

Pas deklaramit të akuzuarit, mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që një pranim i tillë bëhet në mënyrë vullnetare dhe se është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë si dhe ky pranim i fajësisë është në përputhje të plotë me provat dhe gjendjen faktike si në aktakuzë. Gjykata konstatoj se i akuzuari e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i akuzuari është e vetëdijshëm për pasojat dhe benifitet e pranimit të fajësisë për të cilat është njoftuar nga Gjykata, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 të KPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklaramin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklaramit të akuzuarit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara si: Kallëzimi penal me numër 2021-AE-0702, i datës 14.06.2021; Raporti fillestar i incidentit me numër 2021-AE-0702, i datës 27.05.2021; Raporti i policit J. B. #., i datës 27.03.2021; Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëmtuarit i datës 27.05.2021;

Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dyshuarit i datës 19.02.2021 si dhe provat tjera që gjenden të bashkangjitura në lëndë është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, rrjedh se në veprimet e të akuzuarit K. K. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Vjedhje nga neni 313 par 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti më parë kishte sjellje korrekte dhe nuk kishte rënë asnjëherë në konflikt me ligjin. Gjithashtu i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarit ndërsa rrethana rënduese Gjukata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjukata në kuptim të nenit 82 të KPRK-se të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjukata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë.

Gjukata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Gjukata në kuptim të nenit 462 par. 2 të KPPRK-së, palën e dëmtuar e udhëzoi në kontest civil për realizimin e kërkesës së saj pasurore juridike.

Duke u bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjukata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 €uro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364, 498, 499 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL  
P.nr.1707/21 më datë 29.09.2023

**Bashkëpunëtori Profesional**

**Gjyqtarja e vetme Gjykyuese**

**Albrim Kastrati**

**Laura Hoti Statovci**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.